



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr.regj. 24884/2011

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtës, në procedurën kundërvajtës kundër të pandehurit Arbnor Kastrati – Këshilltar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, për kundërvajtje nga neni 6 te Ligjit nr. 03/L -151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Deklarimin, dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë peronat Zyrtar e në bazë të nenit 73,74,27,28 nenit 27.al.4 dhe nenit 198 al. 1 pika 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet me dt. 01.11.2013 merre këtë:

AKTVENDIM

PEZULLOHET procedura kundërvajtës ndaj të pandehurit Arbnor Kastrati – Këshilltar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik .

Procedura pezullohet konform nenit 198 al. 1 pika 7, lidhur me nenin 27 alinea 4 të LMK, pasi që ka arritur parashkrimi **Absolut** i ndekjës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtrroi kërkesën nr. 01-3218/2011 të dt.19.07.2011, për zhvillimin e procedurës kundërvajtës kundër të lartpërmendurit e për kundërvajtjen e lartcekur, ku është marr konkluzion. duke propozuar të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri është ftuar me ftes te rregullt me dt. 16.08.2011 te cilën ftesë e pranoi, pro nuk erdhi në gjykatë dhe as nuk e nuk e arsyetoj mos ardhjen e tij, kurse med.t 14.09.2011 është ftuar përsëri ku e pranoi ftesën dhe në emër të tij është paraqitur asistenti i tij Shenoll Kurtishi i cili na njoftoj se Arbënori do te shkoj për në Amerikë për një udhëtim zyrtarë, dhe pasi qe do te kthehet do te lajmërohet ne gjykatë, ku dhe është caktuar seanca me ftes te rregullt për datën 19.09.2011 ,por i njëjti prapa nuk erdhi në gjykatë dhe as nuk e arsyetoj mos ardhjen e tij.

Për sigurimin e prezencës se te pandehurit në procedurë me d.t 29.11.2011 u leshu Urdhëresa për sjellje komandës regjionale (Operatives Regjionale) në Prishtinë , për sjellje te pandehurin, te cilën urdhëresës e kanë pranuan me dt. 30.11.2011.

Me dt. 08.05.2012 i është leshura **Urgjencë** policisë për realizimin e urdhëresës, pro deri me tani e njëjta nuk është realizuar.

Pas ndërmarrjes se te gjitha veprimeve për sigurimin e prezencës se te pandehurit në procedurën kundërvajtës, gjyqtari konstatoi se kundërvajtja është kryer me datën 31.03.2011, dhe nga kjo kohë e deri me tani kanë kaluar ma shumë 2 vite, ku ka ardh deri te parashikimi **Absolut** i ndjekjes

Andaj konform nenit 27 pika 4 dhe nenit 198 al. 1 pika 7 të LMK-së , **PEZULLOJ** Procedurën kundërvajtës ndaj te pandehuri.

Me sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtës

GJYQTARI
Fatmir Behrami

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Divizionit i Kundërvajtës në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të këtij Divizioni.